

## **Njoftim për konsultimin publik lidhur me projektligjin:**

### **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10/2023. “për informacionin e klasifikuar”**

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, në funksion të sigurisë dhe të punës me informacionin e klasifikuar, si dhe problematikave të hasura gjatë punës me informacionin e klasifikuar, të evidentuara nga institucionet të cilat prodhojnë, ruajnë apo përpunojnë informacion të klasifikuar.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet rritja e standardeve që garantojnë sigurinë e informacionit të klasifikuar, gjatë procesit të administrimit dhe mbikëqyrjes së tij, si dhe përmirësimi i punës me informacionin e klasifikuar.

Projektligji, gjithashtu synon, rregullimin e kuadrit ligjor për kryerjen e mbikëqyrjes shtetërore, nëpërmjet inspektiveve, duke parashikuar aktin nënligjor specifik, i cili përcakton rregullat e detajuara të kryerjes së procedurave të inspektiveve, me qëllim përmbushjen me efikasitet të objektivave të këtyre proceseve, atë të mbrojtjes dhe sigurisë së informacionit të klasifikuar në të gjitha disiplinat e tij. Një tjetër faktor i rëndësishëm, është dhe ndjekja detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe nga ato me organizata ndërkombëtare, si NATO dhe Bashkimi Evropian. Në këtë frymë, është e domosdoshme, që procesi i inspektiveve në tërësi, të kryhet nga AKSIK.

Një tjetër objektiv i këtij projektligji, është edhe përcaktimi i aktit nënligjor që rregullon procesin e vetëdijësimit dhe kryerjes së trajnimeve, për personelin që punon me informacionin e klasifikuar, me qëllim edukimin dhe aftësimin e tyre me njohjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për të gjitha disiplinat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.

Ligji nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, është një ligj i cili ka përafruar pjesërisht vendimin e Këshillit të datës 23 shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së” (2013/488 / BE). Në këtë kuadër lind nevoja e përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar për informacionin e klasifikuar me *acquis* të BE-së.

Më poshtë gjendet i publikuar:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10/2023. “për informacionin e klasifikuar”
2. Relacioni i projektligjit.

Palët e interesuara janë të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre, lidhur me këtë projektligj, brenda 20 ditëve pune nga data e shpalljes së këtij njoftimi, në adresën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik: [Merita.Bundo@kryeministria.al](mailto:Merita.Bundo@kryeministria.al)